



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21/01/22 Ref.: 102/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 92-të, të mbajtur më 28 Tetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:
 - Biologji e Organizmave dhe Ekologji, PhD, 180 ECTS;
 - Kimi, PhD, 180 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Biologji e Organizmave dhe Ekologji, PhD, 180 ECTS Ri-akreditim	Behxhet Mustafa Avdulla Alija Agim Gashi Kemajl Bislimi Idriz Vehapi
2	Kimi, PhD, 180 ECTS	Fetah Podvorica Sevdije Govori Ismet Hashani Fatbardh Gashi Tahir Arbneshti Arben Haziri

AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, me qëllim të vlerësimit të këtyre programi të studimit.

Ekipet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit kanë qenë me këtë përbërje: Mladen Krajačić, Melita Kovačević, Antonio Sanchez Pozo dhe Asnate Kažoka.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këto programe, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Biologji e Organizmave dhe Ekologji, PhD, 180 ECTS, bazuar në standardet e vlerësimit të programave të doktoratës, në shtatë fusha të vlerësimit, nga gjithsej 36 standarde thelbësore, ky program i plotëson 13 standarde; ndërsa nga gjithsej 16 standarde plotësuese, ky program i plotëson 5
2. Për programin Kimi, PhD, 180 ECTS, bazuar në standardet e vlerësimit të programave të doktoratës, në shtatë fusha të vlerësimit, nga gjithsej 36 standarde thelbësore, ky program i plotëson 23 standarde; ndërsa nga gjithsej 16 standarde plotësuese, ky program i plotëson 8

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 92-të të mbajtur më 28 Tetor 2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

